



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja e datës 08.05.2008
Salla nr. N.225 ora 11,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Memli Krasniqi, Vlora Çitaku, Adem Hajdaraj, Heset Cakolli, Fatmire Berisha, Donika Kadaj-Bujupi ndërsa mungoi Mark Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkagjiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.. Shqyrtimi i Projektligjit për Sponzorimet në Kulturë, Rini e Sporte
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera
4. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

1. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Sponzorimet në Kulturë, Rini e Sporte.

Në fillim të mbledhjes kryetari i Komisionit i shprehi mirëseardhje anëtarit të ri të këtij Komisioni Hestet Cakolli.

Kryetari i Komisionit, Agim Veliu, kërkoi nga anëtarët e Komisionit të përcaktohen dy apo tre anëtarë të Komisionit referues për shqyrtimin e projektligjeve që janë në këtë agjendë, meqenëse metoda me zgjedhjen e referuesve është më funksionale dhe do të shpejtonte amendamentimin e këtyre projektligjeve.

Anëtarja e Komisionit Vlora Çitaku vlerësoi se do angazhohet në amendamentimin e Projektligjit për Sponzorimet në Kulturë.

Kryetari i Komisionit konstatoi që referues të Projektligjit për Sponzorimet në Kulturë, Rini e Sporte të jenë anëtarët e Komisionit

Vlora Çitaku, Donika Kadaj dhe Memli Krasniqi.

Koha e referimit të referuesve u caktua të jetë për afërsisht dy javë.

Komisioni do të shqyrtojë dhe debatojë për amendamentet e propozuara pas propozimit të referuesve.

Anëtarja e Komisionit Memli Krasniqi kërkoi që lidhur me Projektligjin për Sponzorimet në Kulturë, Rini e Sporte të organizohet një dëgjim publik ku do të ftohej ministri i Kulturës si dhe përfaqësues tjerë të cilët do të kontribuonin në amendamentimin e projektligjit.

Kryetari i Komisionit, konstatoi që dëgjimi publik për Projektligjin për Sponzorimet në Kulturë, Rini e Sporte të mbahet më datë 19.05.08.

Me këtë konstatim u pajtuan anëtarët e tjerë të Komisionit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera

Lidhur me Projektligjin për Ansamblin Kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera Komisioni ngarkoi tre referues që bashkarisht të merren me shqyrtimin dhe amendamentimin e tij.

Referues të këtij Projektligji u caktuan :

Drita Kadriu Enis Kervan dhe Adem Hajdaraj

Afati për procedimin e amendamenteve të këtij projektligji nga referuesit u caktua dy javë.

Drita Kadriu lidhur me projektligjin për Ansamblin Kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera tha se titulli i projektligjit krijon një zbatësi në mënyrën e zgjedhjes së problemeve për këtë çështje kërkoi që paraprakisht të sigurohet transkripti nga leximi i parë i këtij projektligji në seancën plenare.

4. Të ndryshme

Mbledhja e ardhshme e Komisionit do të caktohet pas mbajtjes së dëgjimit publik.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11,40

**Kryetari i Komisionit,
Agim Veliu**